



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

Ipko
Tomaz Seljak
Drejtore
Prishtinë



VENDIM

Lidhur me Rastin Nr. 2021/395 - Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) për
Ipko (Palë përgjegjëse)

Faktet

1. Bazuar në nenin 30, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, marrëveshjet mbi të drejtën e autorit që kanë të bëjnë me ritransmetimin e programeve audio vizuale do të jenë të vlefshme vetëm pasi ato të jenë regjistruar nga shoqatat për administrim kolektiv të të drejtave.
2. Rregullorja KPM-2020/01 për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale ka përcaktuar se pas funksionalizimit të shoqatave për menaxhimin kolektiv të të drejtave, marrëveshjet mbi të drejtën e autorit do të pranohen vetëm pasi ato të jenë regjistruar në këto shoqata.
3. Në bazë të Vendimit 12/36 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 19 tetor 2020, i plotësuar me Vendimin 13/38 të datës 30 tetor 2020, janë përcaktuar tarifat për të drejtat e autorit dhe është hapë rruga që operatorët e shpërndarjes të procedojnë tutje me regjistrimin e marrëveshjeve për të drejtat e autorit në shoqatat për menaxhimin kolektiv të të drejtave të autorit.
4. KPM, me datën 2 nëntor 2021 i ka dërguar Palës përgjegjëse shkresë përmes së cilës i ka kërkuar që në afat prej (30) ditëve, nga dita e pranimit të shkresës, të bëjnë regjistrimin e të gjitha marrëveshjeve për kanalet të cilat janë në ritransmetim nga data e hyrjes në fuqi të Vendimit të Qeverisë dhe për këtë ta njoftojnë Zyrën e KPM-së në lidhje me veprimet që kanë ndërmarrë për të vepruar në pajtim me nenin 30, paragrafin 2, të Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.
5. KPM me datën 12 nëntor 2021, ka pranuar përgjigje nga ana e Palës përgjegjëse, duke theksuar se shoqatat funksionalizohen vetëm atëherë kur arrihet marrëveshje në mes operatorëve dhe shoqatave, pasi që Vapik akoma nuk ka marrëveshje me operatorët. Gjithashtu në pritje të organizimit të takimit të radhës nga ana e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, duke kërkuar nga KPM që ndërhyrjet t'i kontribuojnë procesit të

organizmit të takimit si proces përfundimtar rreth zgjidhjes së kësaj çështje pasi që kërkesa e drejtuar Ministrisë për takim nga ana e juaja do të ishte me efikase.

6. Komisioni i KPM-së me datë 12 prill 2022 mori Vendim që Pala përgjegjëse të sanksionohet me Vërejtje për shkelje të nenit 30, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, duke e obliguar që në afat brenda (15) ditësh nga dita e pranimit të Vendimit të bëjë regjistrimin e të gjitha marrëveshjeve për kanalet të cilat janë në transmetim nga data hyrjes në fuqi të Vendimit të Qeverisë.
7. Edhe pas Vendimit të KPM-së Pala përgjegjëse nuk ka bërë regjistrimin e marrëveshjeve për të drejtat e autorit në shoqatat për menaxhimin kolektiv të të drejtave të autorit, ashtu siç përcaktohet me nenit 30, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

Analiza ligjore

8. Komisioni i Pavarur i Mediave bazuar në analizat e lartpërmendura konstaton se Pala përgjegjëse ka dështuar të bëjë regjistrimin e marrëveshjeve ashtu siç përcaktohet me nenin 30, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, i cili përcakton se:

“Marrëveshjet mbi të drejtën e autorit që kanë të bëjnë me transmetimin dhe ritransmetimin e programeve audiovizuale do të jenë të vlefshme vetëm pasi ato të jenë regjistruar nga shoqatat për administrim kolektiv të të drejtave të cilat licencohen nga Zyra për të drejtën e autorit pranë Ministrisë së Kulturës, në pajtim me nenin 171 të këtij ligji.”

9. KPM ka konstatuar se Pala përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 30, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta pasi që edhe pas afatit (15) ditor të dhënë me Vendim të Komisionit të KPM-së për regjistrimin e të gjitha marrëveshjeve për kanalet të cilat janë në ritransmetim, nuk ka ndërmarrë veprime konkrete për regjistrimin e tyre në shoqatat për menaxhimin kolektiv të të drejtave të autorit.
10. Komisioni duke u bazuar në faktet e lartpërmendura konstaton se Pala përgjegjëse ka dështuar të bëjë regjistrimin e marrëveshjeve ashtu siç përcaktohet nenin 30, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.


Vendim

11. Pala përgjegjëse sanksionohet me gjobë në shumën prej një mijë (1.000) euro në bazë të nenit 30, paragrafi 1.3, të Ligjit të KPM-së për ritransmetim të kanaleve pa marrëveshje valide në kuptim të nenit 30, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, si dhe nenit 21, paragrafi 2.7 të Ligjit Nr. 05/L-047 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, konkretisht nenit 160, paragrafi 2.
12. Obligohet Pala përgjegjëse që në afat prej tridhjetë (30) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij Vendimi, të bëjë ndërprejen e kanaleve në ritransmetim, deri në regjistrimin e

marrëveshjeve në shoqatën për menaxhimin kolektiv të të drejtave, ashtu siç përcaktohet me nenin 30, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, si dhe nenit 21, paragrafi 2.7 të Ligjit Nr. 05/L-047 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, konkretisht nenit 160, paragrafi 2.

E drejta për ankesë

13. Ankesat i parashtrihen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
14. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.

PP. 
Xhevat Latifi
Kryetar



10.10.2022
Datë